



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 19, datë 10.06.2020

**PËR**


**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:  
“QENDËR GRUMBULLIMI PËR RUAJTJEN, DISTRIBUIMIN, DHE EKSPORTIN E  
FRUTAVE, PERIMEVE DHE AGRUMEVE”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË  
LUSHNJE**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Doni Fruits” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,


**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Qendër grumbullimi për ruajtjen, distribuimin, dhe eksportin e frutave, perimeve dhe agrumeve”, me vendndodhje në Bashkinë Lushnje, me zhvillues shoqërinë “Doni Fruits” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr.09, datë 27.04.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.09, datë 27.04.2018, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
BLEDAR ÇUÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOTA

